VENDIM
Nr. 648, datë 8.10.2014

PËR MIRATIMIN E PROTOKOLLIT TË BISEDIMEVE, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË,PËR BASHKËPUNIMIN EKONOMIK PËR ZHVILLIM

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23, të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e protokollit të bisedimeve, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin ekonomik për zhvillim, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PROTOKOLL

I BISEDIMEVE PËR BASHKËPUNIMIN EKONOMIK PËR ZHVILLIM MIDIS KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE GJERMANE, DATË 8 MAJ 2014, NË TIRANË

1. Hyrje

Bisedimet qeveritare për bashkëpunimin për zhvillim midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverise së Republikës Federale Gjermane u zhvilluan në datën 8 maj 2014 në Tiranë. Delegacioni i Republikës së Shqipërisë drejtohej nga Zëvendëskryeministri z. Niko Peleshi. Delegacioni i Republikës Federale Gjermane drejtohej nga znj. Annette Seidel, drejtuese Departamenti në Ministrinë Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim. Listat e pjesëmarrësve të dy delegacioneve janë bashkëngjitur si shtojcë 1 dhe 2. Listat e projekteve të bashkëpunimit teknik dhe financiar janë bashkëngjitur si shtojcë 3 dhe 4.

Bisedimet u zhvilluan në atmosferën e një bashkëpunimi të hapur dhe të mirë. Rezultatet e bisedimeve janë paraqitur në vijim:

2. Kuadri i bashkëpunimit për zhvillim dhe dialogu politik

Pala shqiptare raporton mbi stadin e hartimit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2014 -2020, si dhe për prioritetet e saj politike për vitet në vijim. Ajo raporton edhe për reformat e saj në kuadër të uljes së nivelit të borxhit.

Të dyja palët bien dakord që bashkëpunimi në vitet e ardhshme të mbetet i fokusuar në sektorin e energjisë, ujësjellës-kanalizime, administrimi i mbetjeve, si edhe në zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë, për të cilët në vitet 2010, 2011, 2012 janë hartuar dokumentet e përbashkëta strategjike. Qëllim madhor për bashkëpunimin për zhvillim është përafrimi i mëtejshëm i Shqipërisë me Bashkimin Europian. Pala gjermane nënvizoi se Shqipëria e përcakton vetë shpejtësinë e përmbushjes së reformave në kuadër të përafrimit me BE-në dhe zbatimin e reformave të domosdoshme në të gjithë sektorët. Në këtë kontekst pala gjermane vlerëson si domosdoshmëri arritjen e përparimeve të dukshme në luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe uljes së nivelit të borxhit.

Të dyja palët përshëndesin faktin, që bashkëpunimi dypalësh për zhvillim në sektorët kyç kontribuon edhe për zbatimin e kapitullit 27: Mjedisi dhe ndryshimet klimatike në kuadër të përafrimit me *acquis communautaire* të BE-së.

Të dyja palët përshëndesin bashkëfinancimin e projekteve në Shqipëri me financim të Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe të Komisionit Europian nëpërmjet bashkëpunimit teknik dhe financiar, i cili kontribuon në harmonizimin e ndihmës së huaj dhe në rritjen e efikasitetit.

Pala gjermane thekson se, për zbatimin e suksesshëm të projekteve të përbashkëta, duhet të garantohet mjaftueshëm vijueshmëria e stafit të kualifikuar në institucionet partnere shqiptare. Qeveria e Republikës së Shqipërisë thekson vazhdimin e përpjekjeve për sigurimin e qëndrueshmërisë dhe mirëmenaxhimin e administratës.

Të dyja palët bien dakord që rimbursimi i shpejtë dhe pa probleme i tatimit mbi vlerën e shtuar është i domosdoshëm në funksion të zbatimit të suksesshëm të projekteve të përbashkëta. Pala shqiptare informoi mbi stadin e procesit të verifikimeve në lidhje me përjashtimin nga tatimi mbi vlerën e shtuar të projekteve të BF-së (përfshirë mjetet financiare të mandatuara nga donatorët e tjerë). Në mënyrë që të shmangen vonesat gjatë zbatimit të projekteve, të dyja palët përshëndesin përfundimin e këtyre verifikimeve deri në tetor 2014.

Deklarata antikorrupsion; transparenca

Të dyja delegacionet bien dakord që projektet e bashkëpunimit të përzgjidhen dhe organizohen sipas kritereve të politikave për zhvillim.

Qeveria e Republikës Federale Gjermane dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë bien dakord për vlerësimin e pasojave negative të korrupsionit:

Ai dëmton themelet për një qeverisje të mirë.

Ai shpërdoron financat e pakta dhe ka pasoja negative në zhvillimin ekonomik dhe atë social.

Ai rrezikon besueshmërinë e bashkëpunimit për zhvillim dhe mbështetjen për të nga opinioni publik, si dhe kufizon përpjekjet e të gjithë atyre, të cilët angazhohen për mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm.

Ai pengon konkurrencën transparente dhe të hapur të bazuar në çmim dhe cilësi.

Të dyjaqeveritë do të bashkëpunojnë ngushtë, në mënyrë që të garantojnë transparencë, llogaridhënie dhe integritet gjatë përdorimit të financave publike dhe të përjashtojnë raste të mundshme të praktikave korruptive në bashkëpunimin e tyre për zhvillim.

Transparenca dhe detyrimi për llogaridhënie janë kushte thelbësore për arritjen e zhvillimit dhe efektshmërinë e bashkëpunimit në përputhje me deklaratat ndërkombëtare (Deklarata e Parisit, Planveprimi ACCRA). Prandaj të dyja delegacionet bien dakord se të dyja palët mund të publikojnë informacione për qëllimet, programet dhe aktivitetet e dakordësuara, rezultatet referuar shpenzimeve në kuadër të politikave për zhvillim, si edhe të kushteve, që lidhen me pagesat në kuadër të bashkëpunimit.

3. Dialogu në sektorët kyç të bashkëpunimit bilateral për zhvillim

3.1 Premtimet financiare dhe riprogramimet

Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë merr përsipër që për vitet 2014 dhe 2015 t'i vërë në dispozicion Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të bashkë-punimit dypalësh teknik dhe financiar, një fond të ri në vlerën e 19 milionë eurove. Prej kësaj shume 8 milionë euro janë caktuar për projekte të bashkëpunimit financiar dhe 11 milionë euro për projekte të bashkëpunimit teknik. Krahas kësaj, 2 milionë euro do të riprogramohen nga fondet e miratuara të bashkëpunimit financiar për vitin 2011.

3.1.1. Përmbledhje tabelare e fondeve të miratuara përfshirë riprogramimet

Projekte	BF/B T	BMZ-Nr.	Lloji	Ripro. (euro)	Fond i ri i miratuar (euro)
Sektori kyç: Zhvillimi i qëndrueshëm e social i ekonomisë					
Zhvillim i integruar dhe i qëndrueshëm i zonës B bregdetare	BT		Projekt i ri		1,0 milionë €
Mbrojtja e agrobiodiversitetit në zonat rurale të Shqipërisë	BT	2014.2199.9	Vazhdim		2,0 milionë €
Zhvillim i integruar i ekonomisë dhe nxitja e punësimit	BT	2014.2196.5	Shtesë fondesh		1,0 milionë €
Programi për arsimin dhe formimin profesional	BT	2014.2197.3	Vazhdim		2,0 milionë €
Mbështetje në përafrimin e legjislacionit ekonomik dhe tregtar me normat e BE-së	BT	2014.2198.1	Projekt i ri		1,0 milionë €
Aftësia konkurruese e SME-ve përmes nxitjes së inovacionit e sipërmarrjes	BT	2014.2255.9	Projekt i ri		2 milionë €
Programi për qeverisjen e mirë në funksion të përmirësimit të klimës së investimeve	BT		Projekt i ri		2 milionë €
Shuma: Zhvillim i qëndrueshëm i ekonomisë				0,00	11 milionë €
Uji i pijshëm, menaxhimi i ujërave, kanalizimet/menaxhimi i mbetjeve					
Programi për menaxhimin e mbetjeve (BM)	BF	2014.7010.3	Vazhdim	0,5 mln. € Masë shoqëruese	2 milionë € Masë shoqëruese
Programi për infrastrukturën komunale V	BF	2013.7035.2	Vazhdim		2 milionë € Masë shoqëruese
Programi sektorial i ujit / Programi për furnizimin me ujë të zonave rurale III (MSH)	BF	2014.7013.7	Vazhdim	1,5 mln. € Masë shoqëruese	
Programi sektorial i ujit / Programi për furnizimin me ujë të zonave rurale IV (MSH)	BF	2014.7011.1	Vazhdim		2 milionë € Masë shoqëruese
Shuma: Ujë i pijshëm, menaxhim i ujërave, kanalizimet/ menaxhim i mbetjeve				2 milionë €	6 milionë €
Sektori kyç: Energjia					

Linja unazore 110 kV në jug të Shqipërisë (Përmirësimi i efiçencës së energjisë) MSH	FZ	2014.7009.5	Vazhdim		2 milionë € Masë shoqëruese
Shuma: Sektori kyç energjia					2 milionë €
Shuma e përgjithshme				2 milionë € Riprogramim	19 milionë € Fonde të reja të miratuara

3.2 Sektori kyç "Energjia"

Dialogu sektorial

Të dyja palët bien dakord që furnizimi i besueshëm dhe efiçent me energji elektrike është një kusht i rëndësishëm për zhvillimin e mëtejshëm ekonomik të Shqipërisë dhe të rajonit të Europës Juglindore. Pala gjermane thekson rëndësinë që kanë implementimi i tarifave që mbulojnë kostot për të gjithë përdoruesit e rrymës elektrike (publike dhe private) dhe strukturat efikase të tregut në përmirësimin e vazhdueshëm të sektorit. Në këtë kontekst pala gjermane shpreh keqardhjen, që kriza e likuiditetit të KESH-it ka ndikuar angazhimet në kuadër të BF-së, si dhe angazhimin e investitorëve potencialë privatë.

Pala shqiptare informoi për reformat sektoriale dhe masat e Qeverisë Shqiptare për të stabilizuar situatën në sektorin e energjisë dhe për të ndikuar për zhvillime pozitive.

Të dyja palët bien dakord që zbatimi i marrëveshjeve në kuadër të Komunitetit Energjetik në Evropën Juglindore gëzon një prioritet të lartë. Të dyja palët përshëndesin gjithashtu edhe angazhimin e Qeverisë Shqiptare për forcimin e koordinimit të donatorëve të angazhuar në këtë sektor.

3.2.1 Bashkëpunimi financiar

Linja unazore e transmetimit 110 kV në Shqipërinë e Jugut (Përmirësimi i efiçencës së energjisë nëpërmjet linjës unazore), 2006.6550.5, 2008.6518.8

Fond i ri i miratuar, masë shoqëruese 2 milionë euro

Aktivitetet e projektit, për të cilat ishte rënë dakord më parë, i referoheshin pjesërisht nivelit të shpërndarjes, i cili ndërkohë u privatizua dhe iu shit kompanisë çeke të energjisë CEZ në masën 76 %. CEZ synon t'i kryejë vetë disa prej këtyre aktiviteteve, dhe në këtë mënyrë këto janë shkëputur nga programi. Vëllimi i aktiviteteve të projektit u përshtat me këtë situatë të re dhe u reduktua, në mënyrë që të garantohet funksionimi i sigurt dhe në përputhje me stadin teknik bashkëkohor të linjave të planifikuara të transmetimit. Mjetet financiare të çliruara kësisoj mund të përdoren për rehabilimin e linjave, që kalojnë midis seksioneve, çka është në përputhje me qëllimin e projektit për ndërtimin dhe fuqizimin e unazës. Duke marrë parasysh investimet e parealizuara për shkak të krizës në sektorin e shpërndarjes në fushën e tensionit të ulët dhe të mesëm mund të merret në konsideratë edhe kthimi tek koncepti fillestar. Kur të vijë momenti, pala shqiptare do t'i paraqesë propozimin përkatës palës gjermane për përdorimin e mjeteve financiare të papërdorura të projektit. Pas vonesave të shumta u arrit që në shkurt 2013 të përfundojë dhënia e livrimeve dhe shërbimeve brenda volumit të përshtatur të aktiviteteve. Ndërtimet ndodhen në fazën e përgatitjes.

Të dyja palët bien dakord që përshtatja e investimeve në kuadër të projektit varet nga ecuria e zgjidhjes së mosmarrëveshjes midis Qeverisë Shqiptare dhe CEZ Shpërndarjes, apo edhe nga riorganizimi institucional i nënsektorit të shpërndarjes.

Qeveria Federale vë në dispozicion për këtë masë shoqëruese 2 milionë euro. Të dyja palët mirëpresin masën shoqëruese.

Linja e transmetimit 400 kV Shqipëri-Kosovë (Tiranë-Prishtinë) (2008.6519.6)

Pala gjermane përshëndet përfundimin e tenderëve dhe lidhjen e kontratave për livrimet dhe shërbimet në vitin 2013 si për pjesën shqiptare, ashtu edhe për pjesën kosovare dhe fillimin e punimeve gjatë këtij viti.

Energjia hidrike dhe siguria e digave në kaskadën Mat-Drin (2009.6653.1)

Në kuadër të këtij projekti synohet realizimi i aktiviteteve të ndryshme për përmirësimin e sigurisë së digave dhe, bashkë me të, i sigurisë së popullatës që jeton në rajon dhe i rritjes së efiçencës në hidrocentralet e mëdhenj në lumenjtë Mat dhe Drin.

Pala gjermane shpreh falënderimin për letrën e ministrit shqiptar të Energjisë dhe Industrisë të datës 19.2.2014. Për këtë projekt Qeveria Federale, nëpërmjet notës verbale Ëi-10-444 FZ100/101 të datës 25.9.2009, ka miratuar një kredi të butë të KfW-së në vlerën e deri 20 milionë eurove. Pala gjermane mirëpret propozimin për financimin e rehabilitimit të *Spilleay Gates* në digat e kaskadës si një komponent i programit ekzistues, me rezervën e kryerjes së verifikimit nga ana e KfW-së. Pala

gjermane nënvijëzon domosdoshmërinë e një implementimi të shpejtë të sistemeve të alarmit në vëllimet e përshtatura, sepse për shkak të privatizimit objekt i projektit janë vetëm hidrocentralet mbi lumin Drin. Në këtë kontekst pala gjermane thekson se, duke pasur parasysh situatën aktuale financiare të palës zbatuese të projektit, KESH, financimi i projektit ka si parakusht marrjen e kredisë nga ana e Republikës së Shqipërisë. Pala gjermane thekson gjithashtu se fondet e miratuara bëhen përfundimisht të pavlefshme në rast se marrëveshjet e kredisë nuk do të jenë lidhur brenda 8 viteve pas vitit të miratimit 2009. Për miratimet e vitit 2009 afati përfundon me mbarimin e datës 31.12.2017.

Qeveria Shqiptare siguroi që marrëveshja qeveritare dhe ajo financiare për shumën 20 milionë euro do të nënshkruhet brenda këtij viti.

Efiçenca e energjisë - Programi sektorial për transmetimin e energjisë elektrike (2011.6638.8)

Nëpërmjet notës verbale të datës 21.9.2011 Qeveria Federale ka vënë në dispozicion për këtë projekt një kredi të butë në vlerën e deri 40 milionë eurove. Nëpërmjet këtij projekti synohet fuqizimi dhe zgjerimi i rrjetit të transmetimit në Shqipërinë e mesme. Studimet e realizueshmërisë e kategorizojnë këtë projekt si të prioritetit maksimal. Projekti është verifikuar nga KfW-ja në mars 2014. Gjatë këtij verifikimi pala shqiptare ka shprehur mundësinë për vënien në dispozicion të një garancie shtetërore për vitin 2014.

Linja e transmetimit 400 kV Shqipëri-Maqedoni (2010 66 992).

Projekti përfshin ndërtimin e një linje të re transmetimi 400 kV midis Shqipërisë dhe Maqedonisë, ndërtimin e një nënstacioni në Elbasan (Shqipëri), si dhe ndërhyrjet përkatëse për zgjerimin e rrjetit. Projekti i BF-së u referohet punimeve në anën shqiptare dhe është një pjesë përbërëse e rëndësishme për integrimin e Shqipërisë në rrjetin rajonal të energjisë.

Pala gjermane përmendi përfundimin me sukses të studimit të realizueshmërisë kryer me mjetet financiare të Bashkimit Europian. Zbatimi i projektit në palën maqedonase, për të cilën është dhënë miratimi për financim nga BERZH, ka filluar. KfW-ja mund të bëjë edhe vlerësimin e projektit në palën shqiptare. Premisë për këtë është gjithashtu vënia në dispozicion e një garancie shtetërore të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, sa kohë që kjo nuk është vetë huamarrëse.

Pala shqiptare konfirmoi se do të shprehë së shpejti qëndrimin e saj në lidhje me periudhën për zbatimin e projektit.

3.3 Sektori kyç: Zhvillimi i qëndrueshëm i ekonomisë

Dialogu sektorial

Pala shqiptare informoi mbi prioritetet e saj për zhvillimin ekonomik dhe mbi zhvillimet aktuale në këtë sektor. Pala shqiptare në strategjitë e saj për zhvillimin ekonomik 2014-2020 i kushton rëndësi rritjes së konkurrueshmërisë së sipërmarrjeve që synojnë rritje ekonomike, modernizimit të bujqësisë, mbështetjes së inovatorizmit dhe sipërmarrjes, mbështetjes së qëndrueshme të ekonomisë lokale, si edhe kualifikimit profesional.

Pala gjermane vlerëson prioritetet e palës shqiptare, kontributet e tjera në kuadër të përafrimit me BE-në dhe përmirësimin e kushteve. Pala gjermane e mbështet Shqipërinë në sektorët kyç; të ekonomisë dhe punësimit, zhvillimit rural/ bujqësisë, arsimit dhe formimit profesional, si edhe harmonizimit të legjislacionit ekonomik me normat e BE-së.

Të dyja palët bien dakord që në kuadër të procesit të përafrimit me BE-në është e nevojshme të ndërmerren dhe zbatohen reforma të tjera, në mënyrë që të fuqizohet konkurrueshmëria dhe kuadri rregullator për ekonominë, si edhe të rritet atraktiviteti ekonomik i Shqipërisë.

3.3.1 Bashkëpunimi financiar

Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla në zonat urbane dhe rurale (2010.6571.3)

Projekti shërben për mbështetjen e drejtpërdrejtë të zonave rurale, duke përfshirë agroindustrinë, nëpërmjet shtimit të mundësive financiare për sipërmarrjet shumë të vogla, të vogla dhe të mesme. Nëpërmjet vënies në dispozicion të kredive afatgjata dhe përmirësimit të ofertës financiare të

institucioneve financiare private synohet të jepet një kontribut në mbështetjen e ekonomisë private para së gjithash në zonat rurale të Shqipërisë dhe në këtë mënyrë të krijohen dhe sigurohen të ardhura dhe punësim.

Për premtimin financiar të bërë gjatë negociatave qeveritare në datën 18.5.2010 duhet të lidhet edhe një marrëveshje sipas së drejtës ndërkombëtare (Marrëveshje e BF-së).

Efiçenca energjetike përmes sektorit bankar (2010.6622.4)

Qëllimi i projektit është aplikimi me impakt të gjerë dhe të qëndrueshëm i një instrumenti financiar në sektorin bankar shqiptar, me qëllim dhënien e mbështetjes aktive për investimet në kursimin e energjisë në sipërmarrjet e vogla dhe të mesme, në banesat private dhe, nëse është rasti, në komuna. Aplikimi i një instrumenti të tillë financiar do të çojë si në thellimin dhe zgjerimin e sistemit financiar shqiptar, ashtu edhe në reduktimin e konsumit të energjisë dhe në këtë mënyrë do të kontribuojë për mbrojtjen e klimës.

Për fondet e miratuara gjatë negociatave qeveritare të datës 18.5.2010 duhet të lidhet edhe një marrëveshje sipas së drejtës ndërkombëtare (Marrëveshje e BF-së).

Për të dyja programet e mësipërme, pala shqiptare do të paraqesë në një kohë të shkurtër propozimin për riformulimin e marrëveshjeve qeveritare.

3.3.2 Bashkëpunimi teknik

Projekt i ri: Zhvillim i qëndrueshëm dhe i integruar i zonës bregdetare

Projekt i ri: 1 milion euro

Qëllimi i projektit të ri është krijimi i një qasjeje të re të integruar për zhvillimin e qëndrueshëm të zonës bregdetare duke mbështetur bregdetin jugor të Shqipërisë. Kjo zonë është një ndër rajonet më të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë me sensibilitet mjedisor të lartë. Në kuadër të një procesi gjithëpërfshirës synohet të zhvillohen prioritetet për zhvillimin ekonomik rajonal, duke marrë në konsideratë objektivat e zhvillimit rural dhe menaxhimin e qëndrueshëm të biodiversitetit. Rezultati i parë do të jetë një plan veprimi i integruar për menaxhimin e zonës së bregdetit, i cili do të parashikojë ndërhyrjet për investime, me qëllim rritjen e potencialit turistik, modele të partneritetit publik privat dhe masa në mbrojtje të burimeve natyrore.

Të dyja palët bien dakord që për këtë projekt të alokohen 1 milion euro. Faza përgatitore e projektit do të financohet nga fondet ekzistuese të Fondit për Studime dhe Ekspertë.

Programi i arsimit dhe formimit profesional, 2012.2473.2

Vazhdim projekti 2014.2197.32 milionë euro

Projekti mbështet reformën kombëtare në fushën e arsimit profesional, zhvillimin e mjeteve të informacionit rreth tregut të punës, si dhe zhvillimin e Qendrës Profesionale Shumë-funksionale (QSHF) në Kamëz.

Të dyja palët bien dakord se Qendrës Profesionale Shumëfunksionale (QSHF) në Kamëz i nevojiten fonde shtesë që të mundë të garantojë zgjerimin e një qendre pilot gjithëpërfshirëse. Pala shqiptare siguroi, do të mbështesë kërkimin e fondeve për investime në pajisje nga një palë e tretë.

Të dyja palët përshëndesin vijimin e projektit. Qeveria Federale vë në dispozicion për këtë projekt 2 milionë euro.

Mbështetje e integruar për ekonominë dhe nxitja e punësimit, 2010.2087.4, 2014.2196.5

Faza e fundit: 1 milion euro

Në një fazë përmbyllëse do të vijohet me komponentin e mbështetjes së Zyrës se Pagesave Bujqësore dhe strukturave institucionale të varura prej saj. Këtyre strukturave do t'u jepet mbështetje në realizimin e projekteve të ngjashme me ato të IPARD-it në përputhje me përcaktimet e BE-së (financim i kombinuar me BE-në).

Të dyja palët përshëndesin një fazë të fundit të projektit. Qeveria Federale vë në dispozicion për këtë projekt 1 milion euro.

Mbrojtja e agro-biodiversitetit në zonat rurale të Shqipërisë, 2011.2195.3

Vazhdim projekti 2014.2199.9 2 milionë euro

Projekti kontribuon në mbrojtjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të biodiversitetit në rajonet e Alpeve të Shqipërisë, për një bujqësi të qëndrueshme dhe garantimin e ushqimit, si edhe për zhvillimin e turizmit ekologjik. Në këtë mënyrë projekti mbështet ruajtjen dhe njëkohësisht shfrytëzimin ekonomik të burimeve natyrore në veri të Shqipërisë, si dhe kontribuon në procesin e përafrimit të Shqipërisë me BE-në. Për palën shqiptare institucioni përgjegjës për këtë projekt është Ministria e Mjedisit.

Të dyja palët përshëndesin vazhdimin e projektit. Qeveria Federale vë në dispozicion për fazën e re të projektit 2 milionë euro.

Projekt i ri: Mbështetje në përshtatjen e legjislacionit ekonomik dhe tregtar me normat e BE-së, 2014.2198.1

Projekt i ri: 1 milion euro

Qëllim i këtij projekti të ri është përshtatja e pjesëve të rëndësishme të legjislacionit ekonomik me normat e BE-së, çka përbën edhe një kusht për integrimin e ekonomisë shqiptare në tregun e brendshëm të BE-së. Këtu bëjnë pjesë *acquis communautaires* të Bashkimit Evropian, ndër të tjera kapitujt që trajtojnë qarkullimin e lirë të mallrave, hapjen e degëve të një shoqërie dhe qarkullimin e lirë të shërbimeve, shoqëritë tregtare, pronësinë intelektuale, sipërmarrjet dhe industrinë, mbrojtjen e konsumatorit dhe shëndetit dhe marrëdhëniet në tregtinë me jashtë).

Të dyja palët mbështesin një projekt të ri, i cili do të japë një kontribut të rëndësishëm në procesin e përafrimit të Shqipërisë me Bashkimin Evropian në aspektin e legjislacionit ekonomik dhe tregtar. Qeveria Federale vë në dispozicion për këtë projekt 1 milion euro.

Pala shqiptare nënvizon domosdoshmërinë e një mbështetjeje me të fuqishme të strukturave negociuese për anëtarësim me marrjen e statusit të vendit kandidat.

Projekt i ri: Aftësia konkurruese e SME-ve përmes nxitjes se inovacionit dhe sipërmarrjes 2014.2255.9

Projekt i ri: 2 milionë euro

Qëllim i këtij projekti të ri është përmirësimi i aftësisë konkurruese të SME-ve shqiptare përmes inovacionit në produkte, procese dhe modele biznesi. Ky projekt i ri do të fokusohet në konsolidimin e kapaciteteve realizuese të reformave të vendosura në Shqipëri dhe në institucionalizimin e rrjeteve të inovacionit. Në këtë mënyrë synohet të kontribuohet në diversifikimin dhe zhvillimin e mëtejshëm strukturor të ekonomisë kombëtare shqiptare sikurse edhe në adaptimin e standardeve evropiane në këtë sektor.

Pala gjermane vë në dispozicion për këtë projekt të ri fonde në vlerën 2 milionë euro.

Projekt i ri: Programi për qeverisjen e mirë në funksion të përmirësimit të klimës së investimeve

Projekt i ri: 2 milionë euro

Qëllim i këtij projekti të ri është përmirësimi i kuadrit ligjor dhe institucional me rëndësi vendimtare për klimën e investimeve në Shqipëri. Këtu mund të përmendim procedura të thjeshtuara dhe inovative, reduktimin e inefiçencës buro-kratike, nxitjen e transparencës, si dhe iniciativa për zhvillimin ekonomik rajonal. Partner zbatues për këtë projekt është Kryeministria.

Pala gjermane vë në dispozicion për këtë projekt të ri fonde në vlerën 2 milionë euro.

3.3.3 Ky sektor kyç do të mbështetet përmes angazhimit të ekspertëve të CIM-it:

- Një ekspert i CIM-it është angazhuar pranë Dhomës Gjermane të Industrisë dhe Tregtisë në Shqipëri (DIHA) prej fillimvitit 2008.

- Një ekspert i CIM-it për arsimin profesional është vendosur prej vitit 2013 pranë Ministrisë për Mirëqenien Sociale dhe Rininë (më parë pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës).

- Një ekspert i CIM-it është planifikuar të vendoset pranë Universitetit Bujqësor - Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit.

- Një ekspert i CIM-it është planifikuar të vendoset në sektorin e mbështetjes së ekonomisë lokale në Gjirokastër.

- Një ekspert i CIM-it është planifikuar të vendoset në sektorin e administratës publike të orientuar për nga shërbimet.

3.4 Sektori kyç: Furnizimi me ujë dhe menaxhimi i ujërave të ndotura, menaxhimi i mbetjeve

Dialogu sektorial

Të dyja palët konfirmojnë se zbatimi i direktivës kuadër të BE-së mbi ujin është një objektiv qendror dhe afatgjatë në bashkëpunimin dypalësh për zhvillim. Në këtë kontekst me rëndësi qendrore do të ishte para së gjithash arritja e një furnizimi të rregullt të popullsisë duke mbuluar kostot operative me të ardhurat e mbledhura. Veçanërisht i rëndësishëm do të ishte zgjerimi i sistemit të pastrimit të ujërave të ndotura. Në këtë drejtim bashkëpunimi dypalësh për zhvillim ka kontribuuar me financimin e impianteve të pastrimit, që janë tanimë në funksion, në Kavajë, Korçë dhe Pogradec.

Të dyja palët përshëndesin faktin që masterplani kombëtar në sektorin e ujërave për vitin 2013 është përmbyllur në mënyrë të suksesshme duke përfshirë të gjithë aktorët që veprojnë në këtë sektor. Pala shqiptare informoi se do të bëjë të gjitha përpjekjet e duhura përmiratimin e këtij masterplani brenda vitit.

Pala shqiptare lutet për mbështetje në zhvillimin e një sistemi të menaxhimit të integruar të ujërave.

Krahas kësaj, të dyja palët bien dakord se përmirësimi i situatës së furnizimit me ujë dhe menaxhimit të ujërave të ndotura e mbetjeve kontribuon në mënyrë thelbësore në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të Shqipërisë përfshirë këtu edhe nxitjen e turizmit.

Pala gjermane përshëndet faktin, që për qeverinë shqiptare menaxhimi i mbetjeve në mënyrë bashkëkohore dhe miqësore me mjedisin ka prioritet të lartë dhe mirëpriti dëshirën e palës shqiptare për hartimin e një masterplani në sektorin e menaxhimit të mbetjeve për investime në një ekonomi moderne mbetjesh. Të dyja palët bien dakord që për këtë qëllim më parë do të duhet të sqarohen kompetencat ministeriale të palës shqiptare në sektorin e menaxhimit të mbetjeve. Ministria shqiptare e Financave do të informojë palën gjermane rreth masën e dëshiruar të kredive për financimin e masave investuese në sektorin e mbetjeve në vitet e ardhshme. Në këtë mënyrë synohet të garantohet që prioritetet e identifikuara në kuadër të masterplanit të jenë brenda një kuadri realist financiar. Në këto kushte, pala gjermane ofron financimin e një masterplani nga Fondi Global për Studime dhe Ekspertë. Pala gjermane thekson rëndësinë e reformës territoriale të planifikuar nga qeveria shqiptare për organizimin e ardhshëm të menaxhimit të mbetjeve. Rregullimi ligjor dhe licencimi, roli i sektorit privat dhe mbrojtja e klimës përbëjnë ende sfida të mëdha në këtë sektor.

Pala shqiptare theksoi domosdoshmërinë e një ristrukturimi institucional të sektorit të mbetjeve dhe kërkoi një mbështetje teknike në këtë drejtim.

3.4.1 Bashkëpunimi financiar

Programet për infrastrukturën komunale 1-V

(I PN2009.6652.3, II PN2010.6570.5, Ill PN2011.6596.8, IV PN2012.6586.7 (investim) PN2012.7018.0 (Masë shoqëruese), V PN 2013.7035.2 (investim) 2013.7035.2 (Masë shoqëruese)

Shtesë fondesh për masën shoqëruese

PN 2013.7035.3 2 milionë euro

Programet I-IV kanë si qëllim që të përmirësojnë dhe garantojnë furnizimin me ujë të pijshëm dhe menaxhimin e ujërave të ndotura në zonat urbane me çmime që mbulojnë kostot dhe të pranueshme në dimensionin social. Të dyja palët përshëndesin faktin, që me anë të programeve për infrastrukturën komunale I-IV janë realizuar në mënyrë konsekuente masa investimesh të bazuara në performancë. Implementimi i programeve I dhe II ka treguar ndërkohë përmirësime të dukshme të strukturave të mbulimit të kostove të ndërmarrjeve të furnizimit. Në këtë mënyrë mund të krijohet një premisë e rëndësishme për operimin e qëndrue-shëm të investimeve dhe - lidhur me këtë - të kostove operative të rritura në sektorin e menaxhimit të ujërave të ndotura.

Me anë të programeve III dhe IV pala shqiptare është duke zbatuar projektet e para të investimeve të bazuara në performancë në përputhje me prioritetet e masterplanit. Pala shqiptare

synon lidhjen e marrëveshjeve të financimit për fazën përgatitore (financuar me fonde të SECO-s) brenda këtij viti. Pala shqiptare konfirmon se marrëveshjet e kredisë dhe ato qeveritare për fazën e investimeve mund të lidhen në vitin 2015.

Për programin e infrastrukturës komunale V (PN 2013.7035.2 (investim) 2013.7035.2 (masë shoqëruese) Qeveria Federale ka njoftuar në datën 26.11.2013 përmes notës verbale nr.171/2013 të Ambasadës Gjermane miratimin e një kredie të bute në vlerën e deri 40 milionë eurove dhe një masë shoqëruese prej 1 milion eurosh në këtë program duhet të gjejnë zbatim investimet prioritare të identifikuara në masterplan lidhur me furnizimin me ujë dhe largimin - e mundësisht edhe pastrimin - e ujërave të ndotur në nivel komunal.

Të dyja palët përshëndesin rritjen e fondeve për masat shoqëruese. Si shtesë fondesh për këtë masë shoqëruese Qeveria Federale vë në dispozicion 2 milionë euro.

Programi për mbrojtjen e mjedisit në liqenin e Shkodrës, 2002.6667.6

Qëllim i këtij projekti të realizuar në bashkë-punim me SECO-n zvicerane dhe ADA-n austriake është përmirësimi i furnizimit me ujë, sistemimi i shkarkimit i ujërave të ndotura dhe pengimi i derdhjes së tyre në Liqenin e Shkodrës, si dhe aftësimi i UK Shkodër, si zbatues i projektit, për menaxhimin e qëndrueshëm të impianteve. Të dyja palët shprehin keqardhjen që, me gjithë mbështetjen e programit, performanca e UKSH ka pësuar rënie. Për funksionimin e qëndrue-shëm të impiantit të pastrimit Shirokë është e rëndësishme, që sistemi i furnizimit me ujë, ndërtuar në vitin 2009 dhe financuar nga pushteti qendror, të përfundojë plotësisht. Furnizimi i qytetit të Shkodrës me ujë të pijshëm të pastër kështu nuk është plotësisht i garantuar.

Projekti do të mbyllet në mes të vitit 2014 dhe do t'i dorëzohet palës shqiptare. Të dyja palët bien dakord, që edhe pas kësaj do të jenë të nevojshme kontribute të bashkisë dhe pushtetit qendror në përfundimin e sistemit të furnizimit me ujë në Shirokë dhe në funksionimin e qëndrueshëm të impiantit të atjeshëm të pastrimit, sikurse edhe në zbatimin e planveprimit për mbrojtjen e fushës së puseve në Dobraç.

Të dyja palët bien dakord që fondet prej 2 milionë eurosh, tanimë të panevojshme për projektin, të riprogramohen.

Programi sektorial për ujin/Furnizimi me ujë i zonave rurale III, 2011.6637.0 (investim), (masë shoqëruese PN2014.7013.7) 1,5 mil. € (Riprogramim nga 2002.6667.6)

Qëllimi i projektit është shfrytëzimi i sistemeve të rehabilituara apo të ndërtuara rishtazi të furnizimit me ujë dhe eventualisht planifikimi i masave shtesë në funksion të një furnizimi të besueshëm me ujë të pijshëm dhe të menaxhimit të ujërave të ndotura.

Pala shqiptare planifikon lidhjen e kontratave dhe marrëveshjeve të financimit brenda këtij viti. Për këtë projekt, me anë të notës verbale të datës 21.9.2011, është njoftuar miratimi i një kredie zhvillimi në kushtet e BF-së në vlerën e 24 mil. Eurove. Për financimin e investimeve është rënë dakord për një grant të BE-së në vlerën e 10 milionë eurove.

Të dyja palët bien dakord që për masën shoqëruese të riprogramohen 1,5 milionë euro nga"Programi për mbrojtjen e mjedisit në liqenin e Shkodrës" (2002.6667.6).

Programi sektorial për ujin/Furnizimi me ujë i zonave rurale IV, PN 2014.6744.8 (investim) dhe masë shoqëruese 2014.7011.1

Masë shoqëruese 2 milionë euro

Qëllimi i projektit është shfrytëzimi i sistemeve të rehabilituara apo të ndërtuara rishtazi të furnizimit me ujë dhe eventualisht planifikimi i masave shtesë në funksion të një furnizimi të besueshëm me ujë të pijshëm dhe menaxhimit të ujërave të ndotur.

Pala shqiptare theksoi që masave të investimit në zonat me potencial turistik, t'u jepet prioritet maksimal. Pala shqiptare theksoi me tej që menjëherë pas hyrjes në fuqi të marrëveshjeve të kredisë dhe financimit të fillohet me zbatimin e masave përgatitore.

Të dyja palët bien dakord se për investimin duhet të parashikohen mjete të reja financiare. Për

masën shoqëruese pala gjermane vë në dispozicion 2 milionë euro.

Programi për menaxhimin e mbetjeve 2013.6645.9 (investim), 2014.7010.3 (masë shoqëruese).

- Masë shoqëruese fond i ri i miratuar: 2 milionë euro
- dhe Riprogramim

nga 2002.6667.6 0,5 mil. euro

Programi përfshin financimin e projekteve të investimit dhe masave shoqëruese për mbledhjen dhe grumbullimin sistematik, në mbrojtje të mjedisit dhe kushteve higjienike të zonave të banuara, si dhe në mënyrë ekonomike të mbetjeve urbane në bashki të mesme e të mëdha. Me anë të notës verbale 171/2013 të datës 26.11.2013 pala gjermane ka vënë në dispozicion të këtij projekti një kredi të butë në vlerën e 12 milionë eurove.

Qeveria Federale vë në dispozicion të masës shoqëruese fonde të reja në vlerën e 2 milionë eurove. Të dyja palët përshëndesin plotësimin e projektit me një masë shoqëruese në vlerën e gjithsej 2,5 milionë eurove, prej të cilave 0,5 mil euro riprogramohen nga "Programi për Mbrojtjen e Mjedisit në Liqenin e Shkodrës" (2002.6667.6).

Biosfera në rezervatin ndërkufitar të liqenit të Prespës, 2001.6678.85, 2006.4046.6, 2013.6646.7

Me anë të notës verbale nr. 171/2013 të datës 26.11.2013 Qeveria Federale ka njoftuar miratimin e një fondi tjetër prej 3,5 mil eurosh për zgjerimin e programit. Me këtë hap synohet të mbështetet biodiversiteti unik i dy parqeve kombëtare në kufi me njëri-tjetrin në rajonin e Prespës. Nëpërmjet projektit synohet të reduktohet trysnia në shfrytëzimin e burimeve natyrore dhe të kontribuohet në luftën kundër varfërisë në pjesën shqiptare. Në kuadër të një mase plotësuese do të financohen investime të tjera në parkun Kombëtar të Prespës me qëllim konsolidimin e aktiviteteve të nisura, si dhe masa të tjera përgatitore në ndërtimin e një rezervati të ri ndërkufitar të biosferës, që shtrihet në pjesën shqiptare. Pala Gjermane thekson që numri i punonjësve të nevojshëm të rritet në masën e duhur dhe që parku kombëtar i Prespës të gëzojë statusin e parkut të pavarur, sikurse është rënë dakord.

Me qëllim që financimi i zonave të mbrojtura të rezervatit ndërkufitar të biosferës në rajonin e Prespës të vendoset në baza të qëndrueshme për të ardhmen, po punohet në koordinim të ngushtë përmbajtjesor me Fondacionin MAWA dhe KfW-në për strukturimin e një fondi ndërkufitar (*Prespa Conservation Trust Fund*). Studimi përkatës i realizueshmërisë, i financuar nga Fondacioni AWA dhe realizuar nga WWF Greqi, është duke u zbatuar që prej nëntorit 2013. Për zbatimin e studimit të realizueshmërisë (Konceptimi nga *Prespa Trust Funds*) dhe për procesin shoqërues në ngritjen e *Prespa Trust Fund* vlerësohet se do të duhen 18 muaj.

3.4.2 Bashkëpunimi teknik

Reforma në sektorin e ujit, 2012.2062.3

Pala gjermane përshëndet dhe mbështet iniciativën e palës shqiptare për të hartuar një strategji lidhur me reformën në sektorin e ujit (2011) duke marrë në konsideratë ristrukturimin sipas reformës territoriale, që ka nisur. Pala gjermane mbështet gjithashtu edhe një kuadër rregullator të orientuar drejt çmimeve të përballueshme, që mbulojnë kostot, dhe nga shërbime cilësore në përputhje me normat ndërkombëtare. Në funksion të ruajtjes së aftësisë paguese dhe mbrojtjes së mjedisit, pala gjermane nxit përpjekjet e qeverisë shqiptare dhe operatorëve përkatës në drejtim të rritjes së efiçencës, veçanërisht të efiçencës së energjisë.

Pala gjermane përshëndet shprehjen e interesit nga ana e qeverisë shqiptare për një bashkëpunim më të ngushtë teknik në sektorin e menaxhimit të mbetjeve. Projekti që është duke u zbatuar, po planifikon ndërkohë një udhëtim studimor ndërministerial (për menaxhimin e integruar të mbetjeve) në Gjermani.

3.4.3 Ky sektor kyç do të mbështetet përmes angazhimit të një eksperti të integruar të CIM-it në impiantin e pastrimit të ujërave të ndotura në Durrës (prej shtatorit 2014).

Angazhimi i një eksperti tjetër CIM në sektorin e menaxhimit të mbetjeve (me fokus të mundshëm: koordinim ndërsektorial, monitorimi i zbatimit të strategjisë, licencimi) duhet ende të

shqyrtohet.

4. Bashkëpunimi jashtë sektorëve kyç

4.1 Bashkëpunimi teknik

Fondi për studime dhe ekspertë, 2002.3513.5

Fondi për Studime dhe Ekspertë (FSE) shërben për përgatitjen dhe shqyrtimin e projekteve të bashkëpunimit teknik, si dhe për financimin e studimeve apo ekspertizave të ndryshme. Po kështu, përmes FSE-së mund të realizohen edhe masa/projekte të tjera të bashkëpunimit teknik në vlerë të ulët.

Nga FSE deri më tani janë financuar (fonde të miratuara 2012) projekti i vogël i "Turizmit kulturor në Gjirokastër" dhe verifikimet e projekteve të bashkëpunimit teknik"nxitje e aftësisë konkurruese në zonat rurale", "Mbështetje për ekonominë dhe nxitja e punësimit" dhe"Mbështetje në përshtatjen e legjislacionit ekonomik dhe tregtar me normat e BE-së".

Pala shqiptare e konsideron të domosdoshme shtesën e Fondeve për Studime dhe Ekspertë. Pala gjermane e vendos në perspektivë këtë shtesë fondesh pas hyrjes në fuqi të buxhetit të Qeverisë Federale në mes të vitit 2014.

4.2 Bashkëpunimi financiar

Pala shqiptare propozon ngritjen e një instrumenti strategjik të përgatitjes së projekteve, me qëllim ndërtimin e një platforme kombëtare të investimeve në infrastrukturë dhe të programeve sektoriale për investime.

Pala gjermane sqaron se instrumentet e bashkëpunimit financiar dhe teknik i referohen përgatitjes së projekteve të cilat mund të planifikohen me financim nga Gjermania ose bashkëfinancim me donatorë të tjerë.

Pala gjermane siguron se do të shqyrtojë propozimin e palës shqiptare në një kohë të shpejtë.

4.3 Instrumente të tjera në dispozicion

Një ekspert CIM është i angazhuar në sektorin e urbanistikës në Bashkinë e Tiranës deri në fund të gushtit 2015. .

Një ekspert CIM është i angazhuar në sektorin "Cultural Heritage Without Borders-Trashëgimia kulturore e Gjirokastrës" deri në gusht 2014.

5. Projekte rajonale

5.1 Bashkëpunimi teknik

Pala gjermane vë në dispozicion fonde shtesë të bashkëpunimit teknik për përfshirjen e Shqipërisë në programe rajonale, të cilat janë në dobi të të gjitha shteteve pjesëmarrëse. Qendra e dy projekteve vijuese është në Shqipëri:

- Mbrojtja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i biodiversitetit në rajonin e liqeneve të mëdhenj të Prespës, Ohrit dhe Shkodrës (PN 2011.2196.1; Shqipëri, Maqedoni, Mal i Zi). Ndërkohë është duke u përgatitur projekti vijues.

- Përshtatja me ndryshimet e klimës në Ballkanin Perëndimor (PN: 2011.9774.8) Projekti synon të përmirësojë përshtatjen me ndryshimet klimaterike duke patur parasysh veçanërisht rrezikun e përmbytjeve dhe thatësirës. Projekti bashkëpunon me pesë shtete: Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbi, në nivel rajonal, kombëtar dhe komunal.

Krahas kësaj Shqipëria merr pjesë në projekte të Fondit të Hapur Rajonal (FHR) për Europën Juglindore. FHR shërben për intensifikimin shkëmbimeve mes vendeve fqinje në tematikat përkatëse:

- FHR Konsulencë për Ekonominë e Jashtme, me qëllim përmirësimin e aftësisë konkurruese dhe tregtisë në rajon;

- FHR Modernizimi i Shërbimeve Komunale, me qëllim mbështetjen e shkëmbimit të përvojës së rrjeteve komunale në përmirësim të shërbimeve komunale;

- FHR Konsulencë Juridike, me qëllim mbështetjen e reformave në sektorin juridik dhe legjislative në rajon;

- FHR Efiçenca e Energjisë, me qëllim mbështetjen e shkëmbimit të përvojës mes institucioneve, që

angazhohen për inovacionin në sektorin e efiçencës së energjisë.

Aplikimet për përdorimin e këtij fondi mund të paraqiten tek GIZ-ja si nga institucionet shtetërore sikurse edhe nga subjekte private (p.sh. dhomat, shoqatat, universitetet). Në zbatimin e një projekti të veçantë të FHR-së janë së paku tre vende pjesëmarrëse.

6. Instrumente të tjera dhe kontributet e BZH-së

Pala gjermane thekson se krahas bashkëpunimit dypalësh, që është në qendër të këtyre bisedimeve, ajo merr pjesë si vend me kontribut financiar edhe në programe dhe projekte të Bashkimit Europian. Përveç kësaj Gjermania është aksionari i katërt më i madh në Bankën Botërore dhe pjesëmarrëse me mbi 8,5 % në BERZH. Gjithashtu Gjermania mbështet financiarisht programet e Kombeve të Bashkuara dhe organizatat e posaçme apo të varura prej tyre.

Pala gjermane mbështet gjithashtu:

- "Krijimin e një marke cilësie për qëndrue-shmërinë me fokus tek efiçenca energjetike dhe mjedisi për sipërmarrjet shqiptare të turizmit" në kuadër të *Public Private Partnership*;

- Turizmin malor në Majat e Rajonit të Ballkanit (*Peaks of the Balkans Region*) në kuadër të *Public Private Partnership*;

- Projektin e Caritas-it Gjerman me të rinjtë dhe fëmijët në Tiranë dhe Cërrik;

- Projektin e Shërbimit Protestant për Zhvillim "*Human Rights in Democracy Center* - Mbrojtja e të Drejtave të Njeriut dhe mbështetje social-ekonomike veçanërisht për personat me aftësi të kufizuar";

- Dërgimin e një asistenti si konsulent dhe instruktor të teknikës ortopedike nga shërbimiProtestant për zhvillim;

- Punën e fondacioneve politike *Friedrich Ebert, Konrad Adenauer* dhe *Hanns Seidel* në Shqipëri.

7. Deklarata dhe klauzola përmbyllëse

a) Kushte për zbatimin e projekteve

Të dyja delegacionet bien dakord, që të gjitha kontributet e palës gjermane të parashikuara në këtë protokoll do të mund të realizohen vetëm pasi:

- Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë të ketë marrë një vendim pozitiv pas verifikimit përkatës të projekteve i programeve përmes KfW-së, GIZ-së dhe ose një organizate tjetër të ngarkuar me zbatimin;

- Financimi i përgjithshëm i projektit/ programit të jetë i garantuar;

- Marrëveshjet ndërkombëtare, që nuk janë lidhur ende (marrëveshjet qeveritare dhe ato mbi projektet/programet), marrëveshjet e financimit dhe ato të kredive, si dhe marrëveshjet e zbatimit me KfW-në dhe GIZ-në apo me organizatat përkatëse zbatuese, të kenë hyrë në fuqi.

b) Përgatitja e projekteve të BF-së

Të dyja palët bien dakord që për përgatitjen dhe shoqërimin e mëtejshëm të projekteve të dakorduara gjatë këtyre bisedimeve qeveritare mund të lindë nevoja e realizimit të studimeve, vlerësimeve dhe e angazhimit të eksperteve të ndryshëm. Këto masa do të koordinohen nga KfW me instancën përgjegjëse të sektorit. Fondet për këtë qëllim do të vihen në dispozicion nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë duke iu shtuar atyre fondeve tashmë të miratuara në bashkë-punimin financiar dypalësh. Të dyja palët do të informojnë gjatë bisedimeve konsultimeve të ardhshme qeveritare rreth zbatimit dhe rezultateve të këtyre masave.

c) Klauzola e zhvlerësimit/këmbimit; fondet e mbetura

Pala gjermane sjell veçanërisht në vëmendje se fondet e miratuara në kuadër të Bashkëpunimit Financiar dhe bashkëpunimit teknik bëhen përfundimisht të pavlefshme, në rast se marrëveshja e zbatimit, që do të thotë: për BF marrëveshjet e kredisë i financimit, dhe për BT kontratat e zbatimit, nuk lidhen brenda një afati prej 8 vjetësh pas vitit të miratimit. Për miratimet e vitit 2011, ky afat do të përfundojë me datë 31.12. 2019. Për miratimet e vitit 2014, ky afat do të përfundojë me 31.12. 2021.

Në rast se një apo disa prej projekteve nuk është/janë realizuar apo është/janë realizuar vetëm masë të pjesshme, atëherë ai/ata, në marrëveshje mes dy qeverive, mund të zëvendësohen me një/disa

projekte të tjera.

8. Bisedimet e ardhshme qeveritare

Bisedimet e ardhshme të bashkëpunimit për zhvillim mes Këshillit të Ministrave të Republikës se Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë do të zhvillohen në vitin 2016.

Protokollet e ardhshme të konsultimeve dhe bisedimeve do të hartohen në gjuhën angleze.

Tiranë, më 8 maj 2014

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

ZËVENDËSMINISTËR
Niko Peleshi

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË

MINISTRIA FEDERALE PËR BASHKËPUNIM EKONOMIK DHE ZHVILLIM
Annette Seidel